



Newsletter Numër 6



Prill 2020: Qendra Historike Vlorë

E dimë sa shumë ju mungojnë shëtitjet buzëmbremje në kalldrëm apo pazari i qytetit e kafenetë ku "mbledhjet e mëngjesit" ju jepnin ritmin e ditës. Por sot me distancën sociale teksa përshëndetemi nga larg po ndërtojmë "mburojën" për veten dhe familjen tonë.

Sepse kur kjo situatë sa paniku aq edhe përballje të përfundojë do të shihemi sërish, TË GJITHË, TË NESËRMEN ashtu zhurmshëm e plot jetë, në një Shqipëri të rindërtuar me hapësira të reja për të ndërvepruar.

Hapësira publike është elementi më demokratik i një qyteti

Kjo është një prej deklaratave nga Richard Rogers - Arkitekt britanik, fitues çmimesh, i njohur për veprat e tij, përfshirë Qendrën Pompidou në Paris si dhe ndërtesën e Lloyd dhe Kubenë e Mijëvjeçarit në Londër. Në ditët e sotme sheshet dhe hapësirat publike të ndërtuara apo në proces e sipër janë “Agora” moderne, vendtakim mes brezash dhe qytetërimesh.

Secili prej nesh mund të ketë eksperiencën e tij personale, kur vizitojmë qendra urbane dhe qytete. E kemi rastisur veten dhe miqtë duke thënë shpesh, ndërtesat mund të jenë me arkitekturë nga më të veçantat, por hapësirat publike “të çlodhin sytë”. Kontakti është sa personal si në kënaqësinë e një shëtitjeje, aq dhe të mbledhjes me miqtë e tu për bisedat e pasdites.

Hapësirat publike formësojnë një qytet dhe i japin frymëmarrje. Një shoqëri e qytetëruar varet nga hapësirat e mira publike. Mbart elementë të demokracisë për sa kohë tek një qytetar nxit ndjesinë e përkatësisë dhe barazisë. Të gjithë kanë akses, pavarësisht lagjes ku banojnë.

Me një shtrirje horizontale, në ndryshim nga çdo vepër tjetër, jo institucioni por Njeriu është qendra.

Hapësirat publike qofshin këto sheshe, bulevarde, shëtitore etj janë investimet më të mira që mund të bëhen. Kjo pasi përfitues direkt janë jo vetëm banorët e zonës, por edhe turistët vendas dhe të huaj, të cilët gjithashtu janë në përpjekje për të krijuar “raport” me vendin që eksplorojnë. Ky raport përkthehet gjithashtu në të ardhura monetare për grupet e interesit ku zbatohet projekti.

Çelësi është të bësh ndërhyrje në raport me mjedisin dhe për të mbrojtur ekosistemet ekzistuese. Të planifikuara me shumë kujdes, që dhe përmirësimet të jenë graduale. Kështu fluksi i madh i vizitorëve përballohet nga punimet cilësore në harmoni me natyrën.

Në këtë mënyrë pavarësisht rritjes së popullsisë, që do të thotë qytete me dendësi më të lartë, janë hapësirat publike që projektojnë dhe e bëjnë qytetin të dallojë si një i tërë, kompakt.



Përshtypjet e para për ndryshimet e fundit!

Jemi në muajt e fundit të punimeve në qytetin e Roskovecit, me vëmendje të shtuar ndaj rikualifikimit urban dhe ndërtimit të qendrës së re. Me financim të Qeverisë Shqiptare është një tërësi ndërhyrjesh të cilat në shërbim të banorëve, synojnë të krijojnë ambiente rekreative dhe funksionale.

Sheshi nënkupton një pikë takimi, për të gjithë brezat. Punëtorët vijojnë të shtrojnë pllakat e gurta në sipërfaqet e mbetura dhe ndërkohë mund të vësh re “lëvizjet e paduruara” të fëmijëve, të cilët kanë një vend të ri për të luajtur. Hapësira e re për zotërinjtë e moshuar, të cilët lojën e dominosë e luajnë me të njëjtin nerv edhe pas kalimit të viteve. “Ja sheshi, ja mejdani”. Dhe mundësia që të shtosh ekonominë dhe biznesin, ku pas një kopështi për fëmijë, të hapësh dhe një kafene pasi pritet të shtohen lëvizjet, sidomos në pranverë.

Vetë banorët dëshmojnë:

... “Më përpara kanë qenë ca depo të vjetra, minj, papastërti gjithandej-ça të të tregoj! Skandal fare, me baltë me të tëra, tani ka dalë në dritë. E kanë bërë super. Kanalizimet janë bërë të mira, nuk përmbytemi më, në hyrje. Të bjerë ç’të dojë tani, vetëm tërmetit skemi ç’ti bëjmë”. **Banor i zonës**

“Tani puna është shumë e mirë, fshati që duket s’do kallauz. Pallatet atje tej njëher ishin si në mesjetë. Po mendoj tani që afron pranvera, ka lëvizje, xhiro mbasdite. Të hap dhe një kafene këtu përballë, të shohim si do shkojë”. **Banor i zonës**

“Ujë deri në mes të trupit. Unë këtu e kam marrë astmën. Nuk zbrisje dot poshtë se uji i kishtë mbuluar shkallët që pa gdhirë. Tani shiko gjelbërim, pastër e shtruar. Ja ulemi me motrën këtu, në diell. Ne veç të mira ju urojmë juve”. **Banore e zonës**



60.000 m² - Hapësirë e re Urbane në Fier

Drejt përfundimit për rikualifikimin urban të qendrës së Fierit dhe rehabilitimit të Lumit Gjanica, një ndër projektet më të mëdha të ndërmarra në këtë qytet vitet e fundit.

Projekti, që financohet nga Qeveria Shqiptare dhe zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka për qëllim të shndërrojë qendrën e Fierit dhe lumin Gjanica në zemrën e këtij qyteti. Sheshi qendror i qytetit është pika e takimit të pesë rrugëve të qytetit. Pas investimit të kryer për rehabilitimin e këtyre rrugëve rikonceptimi i sheshit dhe i lumit Gjanica përmbyllin objektivin për të ndryshuar rrënjësisht qendrën e qytetit jugor. Në kuadër të të njëjtit projekt punohet edhe për rinovimin e fasadave të ndërtesave rreth sheshit, ndërtimi i korsive të biçikletave, punime ndriçimi.

Për më shumë info: <https://www.albaniandf.org/2020/02/07/60000-metra-katrore-hapesire-urbane-ne-fier/>



Liqeni i Shkodrës, më i madhi në Gadishullin e Ballkanit

A e dini se?

Ai shtrihet në kufirin ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ekosistemi i liqenit dhe zonat ujore ushqejnë faunën dhe florën e pasur dhe unike, duke e shndërruar atë në një qendër të rëndësishme biodiversiteti në Evropë. “Rikualifikimi i bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës” është një ndër projektet më të fundit, me financim të Qeverisë Shqiptare. Pjesë e tij është dhe projekti “Rikonstruksioni i Sheshit të Shirokës”, i cili është drejt përfundimit. 10900 m² deri më tani shtruar në gurë, që do të ndiqet dhe nga punimet për mobilimin urban.

